



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC



Më
Dana

29-06-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:005646
Datë: 30.04.2018
Numri i dokumentit: 00031977

P.nr.303/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal- në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] [REDACTED] pa nr., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1917-1/2017 të datës 22.02.2018, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1917-1/2017 të datës 22.02.2018 për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 30.04.2018 mori:

AKTGJYKIM

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1917-1/2017 të datës 22.02.2018, gjykata jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., i lindur më [REDAKTUAR] në të njëjtin vend nga babai [REDAKTUAR] e e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] ka të kryer shkollën e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon numrin personal [REDAKTUAR] shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse : më datën 02.09.2017 rreth ores 18:00 në Rrugën "Rexhep Bislimi" në Ferizaj te objekti i Fakultetit të Shkençave Aplikative ,pas një mosmarrëveshje të mëherëshme në mesd të pandehurit dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR] i pandehuri me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore duke e goditur me grushta në fytyrë , me çka i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit me pasoja të përkohëshme për shëndetin të përshkuara në Ekspertizën mjeko-ligjore të dt.15.02.2018,-

Me të cilën ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

GJYKON

Me DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 euro(me shkronja:Dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të marr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 1917-1/17 të datës 22.02.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 1917-1/2017 të datës 22.02.2018, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, e njashtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e veprës penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjën e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Deklaratat e të pandehurit dhe të dëmtuarit, si dhe Ekspertizën mjeko ligjore të dt.15.02.2018, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor kanosja nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit denimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me denim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 463 të KPPRK-së, I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt , për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së,i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, si dhe shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.303/18, datë 30.04.2018

Zyr.ligjor
Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,

Elmaz Zenuni



Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Ndërkaq,pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nga një kopje u dërgohet PTH-së dhe të dëmtuarit.